



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 6 tetor 2017
Nr. ref.:RK 1134/17

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI57/17

Parashtrues

“KLENAK – DOO”

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I-16-0075-A0001, të 5 janarit 2017

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga kompania “Klenak-DOO” nga Krushevc, Republika e Serbisë (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), të cilën e përfaqëson Abit Asllani, avokat nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Apelit) AC-I-16-0075-A0001, të 5 janarit 2017.
3. Aktgjykimi i kontestuar i Kolegjit të Apelit i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 17 janar 2017.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të kontestuar, me të cilin pretendohet të jenë shkelur të drejtat dhe liritë e parashtruesit të kërkesës të garantuara me nenin 21 [Parimet e Përgjithshme], nenin 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 46 [Mbrojtja e Pronës], nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut], nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave], nenin 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore], nenin 56 [Të Drejtat dhe Liritë Themelore gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme], nenin 57 [Parimet e Përgjithshme] dhe nenin 58 [Përgjegjësitë e Shtetit] në lidhje me Kapitullin III [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 16 maj 2017, parashtruesi dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 17 maj 2017, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Arta Rama-Hajrizi.
8. Më 26 maj 2017, Gjykata informoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe një kopje të kërkesës ia dërgoi Kolegjit të Apelit.
9. Më 6 shtator 2017, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Parashtruesi i kërkesës është kompania e cila deri më 2 dhjetor 1997, i ka ofruar shërbimet e saj Ndërmarrjes shoqërore "LUX" (në tekstin e mëtejme NSH "LUX") nga Mitrovica.
11. Më 27 shtator 2013, parashtruesi dorëzoi kërkesën në Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: AKP), me të cilën kërkoi pagesën e borxhit të cilin NSH "LUX" nuk e ka paguar për periudhën prej 4 shkurtit 1997 deri më 2 dhjetor 1997.
12. Më 23 tetor 2013, AKP-Autoriteti i Likuidimit i NSH "LUX" mori vendimin [MIT 039-0011] me të cilin kërkesën për pagesën e borxhit të parashtruesit e refuzoi si të pabazuar për shkak të parashkrimit.
13. Më 25 nëntor 2013, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Dhoma e Posaçme) kundër vendimit të AKP-së të 23 tetorit 2013.
14. Më 14 maj 2014, AKP-ja paraqiti përgjigje në ankesë të parashtruesit në Dhomën e Posaçme, duke pretenduar se ankesa e parashtruesit është e parashkruar.
15. Më 23 mars 2016, Dhoma e Specializuar e Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Dhoma e Specializuar) nxori Aktgjykimin [C-IV-13-3274], me të cilin ankesën e parashtruesit të kërkesës e refuzoi si të pabazuar. Në arsyetimin e aktgjykimit theksohet:

"Vendimi i atakuar është i drejtë i bazuar, i arsyetuar mirë, nuk përmban shkelje procedurale, është i qartë dhe i kuptueshëm për palët dhe i përmban të gjitha faktet vendimtare mbi të cilat bazohet.

[...]

"Sipas Nenit 374, paragrafi 1 i Ligjit për Detyrimet (GZ e RSFJ Nr. 29/78) parashihet që: "kërkesat reciproke të personave shoqëror - juridik nga kontrata në qarkullimin e mallrave e të shërbimeve si dhe kërkesat për shpenzimet e bëra lidhur me këto kontrata parashkruhen për 3 vjet."

16. Parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Kolegjin e Apelit kundër Aktgjykimit të Kolegjit të Specializuar [C-IV-13-3274].
17. Në të njëjtën kohë, AKP-ja i dërgoi përgjigje Kolegjit të Apelit.
18. Më 5 janar 2017, Kolegji i Apelit nxori Aktgjykimin [AC-I-16-0075-A0001], me të cilin ankesën e parashtruesit të kërkesës e refuzoi si të pabazuar. Në arsyetimin e aktgjykimit arsyetohet:

“Ankuesi as në ankesë por as në përgjigjen e tij ndaj mbrojtjes së të paditurës, gjykatës nuk i ka parashtruar asnjë provë se ai ka bërë me herët ndonjë kërkesë për pagim të këtij borxhi dhe që iu ka drejtuar gjykatës kompetente, në kohën nga dhjetori i vitit 1997, kur NSH-ja ka ndërprerë pagimin e rregullt të borxhit dhe me këtë veprim do të ndërprehej parashkrimi ...”.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

19. Parashtruesi i kërkesës pretendon: *“Aktgjykimet e kësaj gjykate në të dyja instancat sikur që shihet nuk e kanë kontestuar aspektin faktik të qenësisë materiale dhe ekzistimit të borxhit/detyrimit të Agjencionit të Privatizimit të Kosovës ndaj paditësit këtu, sepse të gjitha pretendimet janë refuzuar me arsyetimin se “ka skaduar afati ligjor i kërkesës lidhur me borxhin...e deri në këtë situatë ka ardhur sepse gjykatat e kanë vërtetuar gabimisht gjendjen faktike dhe gabimisht e kanë zbatuar të drejtën materiale.”*
20. Parashtruesi kërkon nga Gjykata *“ta shpallë të pavlefshëm Aktgjykimin e Dhomës së Specializuar të DHPGJSK dhe Aktgjykimin e Kolegjit të Apelit dhe çështjen lëndore t’ua kthejë të njëjtëve për rigjykim dhe rivendosje .”*

Pranueshmëria e kërkesës

21. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka plotësuar kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të definuara me Ligj dhe më tej të përcaktuara me Rregulloren e punës.
22. Gjykata thekson se, në pajtim me nenin 21.4 të Kushtetutës i cili parasheh që *“Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejné edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme”*, parashtruesi i kërkesës ka të drejtë të dorëzojë ankesë kushtetuese, duke iu referuar të drejtave themelore që vlejné për individë dhe për persona juridikë (Shih: *mutatis mutandis*, Aktvendimi i 27 janarit 2010, Kërkesa KI41/09, *Universiteti AAB-RIINVEST SHPK, Prishtinë kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës*).
23. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 (Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara) të Kushtetutës, të cilët parashohin:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

(...)

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

24. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar; kërkesa është dorëzuar në pajtim me afatet e parashikuara në nenin 49 të Ligjit dhe parashtruesi i kërkesës i ka shterur të gjitha mjetet ligjore.

25. Megjithatë, Gjykata i referohet edhe nenit 48 të Ligjit [Saktësimi i kërkesës], i cili thekson:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

26. Gjykata më tej, i referohet rregullit 36 (1) (d) dhe (2) (b) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

“(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:

[...]

(d) kërkesa nuk arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.

(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

[...]

(b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese”.

27. Në këtë rast, parashtruesi i kërkesës konsideron se gjykatat e rregullta, duke vendosur sipas kërkesëpadisë së tij, gabimisht kanë vërtetuar gjendjen faktike dhe gabimisht e kanë zbatuar të drejtën materiale, që rezultoi që gjykatat të merren vetëm me çështjen procedurale lidhur me parashkrimin e kërkesëpadisë së tij dhe jo me vetë esencën që kishte të bënte me pagesën e borxhit. Me këtë pretendohet se ka pasur shkelje të drejtave dhe lirive të tij kushtetuese.
28. Në lidhje me këtë, Gjykata përsërit se Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ) theksoi *“se roli i gjykatave të rregullta është të interpretojnë dhe zbatojnë të drejtat procedurale dhe materiale”* (Shih: *mutatis mutandis*, *García Ruiz kundër Spanjës* [DHM], nr. 30544/96, paragrafi 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).
29. Gjykata, gjithashtu, përsërit se vërtetimi i plotë i gjendjes faktike është në juridiksion të plotë të gjykatave të rregullta dhe roli i Gjykatës Kushtetuese është vetëm të sigurojë respektimin e të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe me instrumente të tjera ligjore dhe prandaj nuk mund të veprojë si Gjykatë e *“shkallës së katërt”* (Shih: GJEDNJ, rasti *Akdivar kundër Turqisë*, nr. 21893/93, të 16 shtatorit 1996, paragrafi 65; Shih gjithashtu: *mutatis mutandis*, rasti i Gjykatës Kushtetuese: KI86/11, parashtruesi i kërkesës: *Milaim Berisha*, të 5 prillit 2012).
30. Në bazë të kësaj, Gjykata gjen se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për zbatimin e gabuar dhe interpretimin jokonsistent të dispozitave relevante

ligjore, si dhe pretendimet për vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike të cilën pretendohet se e kanë bërë Kolegji i Specializuar dhe Kolegji i Apelit ngrehin çështje të cilat hyjnë në fushëveprimin e gjykatave të rregullta (ligjshmëria), dhe jo në fushëveprimin e Gjykatës Kushtetuese (kushtetutshmëria).

31. Prandaj, kjo Gjykatë do të merret posaçërisht me shqyrtimin e mënyrës me të cilën gjykatat kompetente i kanë përcaktuar faktet dhe në fakte të tilla të vërtetuara kanë zbatuar rregullat pozitive-ligjore, kur është e qartë se në një proces të caktuar ka pasur sjellje arbitrare nga gjykata e rregullt, si në procedurën e vërtetimit të fakteve ashtu edhe në procedurën e zbatimit të rregullave relevante pozitive-ligjore.
32. Megjithatë, Gjykata vëren se parashtruesi në kërkesën e dorëzuar në Gjykatë ka paraqitur të njëjtat çështje që kanë të bëjnë me lëshime procedurale të cilat pretendohet t'i ketë bërë Kolegji i Specializuar kur e ka refuzuar kërkesëpadinë e tij për shkak të parashkrimit, duke u bazuar në rregullat e aplikueshme ligjore, konkretisht në nenin 374, paragrafi 1 të Ligjit për Detyrime.
33. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës kundërshtimet identike i ka paraqitur edhe në Kolegjin e Apelit, i cili në Aktgjykimin [AC-I-16-0075-A0001] është marrë detajisht me to me ç'rast i vlerësoi pretendimet në fjalë si të papazuara, me arsyetimin i cili kësaj Gjykatës nuk i duket arbitrar.
34. Gjykata më tej nuk e gjen arbitrar as Aktgjykimin [AC-I-16-0075-A0001] e Kolegjit të Apelit dhe këtë për arsye se për vendimin e vet ka ofruar shpjegime të qarta të cilat kanë bazë ligjore në dispozitat ligjore përkatëse që kanë të bëjnë pikërisht me çështjen e parashkrimit të kërkesëpadisë.
35. Duke pasur parasysh ato që u thanë më sipër, si dhe rrethanat e rastit konkret, Gjykata në arsyetimin e vendimeve të kontestuara nga gjykatat e rregullta nuk sheh ndonjë arbitraritet në zbatimin e së drejtës materiale. Gjithashtu, nuk mund të gjejë elemente që do të tregojnë një parregullsi apo arbitraritet në marrjen e vendimeve të kontestuara në dëm të parashtruesit të kërkesës.
36. Prandaj, Gjykata konsideron se asgjë në rastin e paraqitur nga parashtruesi nuk tregon se procedurat në gjykatat e rregullta ishin të padrejta apo arbitrare në mënyrë që Gjykata Kushtetuese të bindet se parashtruesit i është mohuar ndonjë e drejtë dhe detyrim i garantuar me Kushtetutë.
37. Gjykata konsideron se obligimi i parashtruesit të kërkesës është që t'i mbështesë pretendimet e tij kushtetuese dhe të paraqesë dëshmi *prima facie* që tregojnë shkeljen e të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe me KEDNJ. Ky vlerësim është në pajtim me juridiksionin e Gjykatës (shih: rastin e Gjykatës Kushtetuese nr. KI19 /14 dhe KI21/14, parashtruesit e kërkesës: *Tafil Qorri dhe Mehdi Sylja*, të 5 dhjetorit 2013).
38. Megjithatë, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës nuk e ka mbështetur pretendimin e tij, as nuk ka treguar se i janë shkelur të drejtat.

39. Prandaj, kërkesa e parashtresit është qartazi e pabazuar, në baza kushtetuese, dhe duhet të deklarohet e papranueshme, në pajtim me rregullin 36 (1) (d) dhe (2) (b) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) d) dhe (2) b) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 6 shtator 2017, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20, paragrafi 4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Altay Suroy



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi